

VENDIM
Nr.823, datë 11.6.2008

**PËR KTHIMIN E SPITALIT UNIVERSITAR TË MUSHKËRIVE “SHEFQET NDROQI”
NË SPITAL UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Spitali universitar i sëmundjeve të mushkërive “Shefqet Ndroqi” të kthehet në spital universitar “Shefqet Ndroqi”, si person juridik, publik, buxhetor, me kapacitet 300 shtretër, i nivelit terciar, që do të shërbejë si qendër e mjekimit, mësimit dhe kërkimit shkencor, për rajonin e Tiranës.

2. Drejtimi administrativ i spitalit të jetë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa drejtimi institucional në varësi të dyfishtë, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si organe, që bashkërendojnë veprimtarinë e spitaleve universitare.

3. Funksionet mjekësore, mësimore dhe kërkimore-shkencore të spitalit të realizohen nga strukturat përkatëse, në nivel departamenti dhe shërbimi, në bashkëpunim me drejtorinë e spitalit.

4. Mënyra e organizimit, struktura dhe rregulloret e funksionimit përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Drejtori i spitalit emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga Ministri i Shëndetësisë.

6. Ministria e Shëndetësisë kryen kompensimin financiar për shërbimin, që kryen stafi akademik i Fakultetit të Mjekësisë në spital, bazuar në kontratat përkatëse.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, dhe organika e spitalit të përballohen, përkatësisht, nga buxheti dhe numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për vitin 2008, për Ministrinë e Shëndetësisë.

8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

9. Në vendimin nr.70, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e spitaleve universitare”, të ndryshuar, të gjithë paragrafët, që i referohen spitalit universitar të sëmundjeve të mushkërive “Shefqet Ndroqi”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha